

20180110115

**L I G J**  
**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR INSPEKSION**  
**ADMINISTRATIV**

Neni 1

Në Ligjin për inspeksion administrativ ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 69/2004, 22/2007, 115/2007, 51/11, 164/13, 41/14, 33/15, 156/15, 193/15 dhe 53/16), në nenin 5 alineja 8 ndryshohet si vijon:

"- posedon vërtetim për njohjen aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë dhe".  
Alineja 9 shlyhet.

Neni 2

Në nenin 7 paragrafi 3 në pikën 4) pikëpresja zëvendësohet me lidhëzën "dhe".

Në pikën 5) në alinenë 4 lidhëza "dhe" zëvendësohet me presje.

Në alinenë 5 lidhëza "dhe" zëvendësohet me lidhëzën "ose".

Pas alinesë 5 shtohet alineja e re 6, si vijon:

"- APTIS (APTIS) - së paku niveli B2 (B2)."

Pika 6) shlyhet.

Neni 3

Dispozitat e nenit 7 paragrafi 3 pika 5) të Ligjit për inspeksion administrativ ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 69/2004, 22/2007, 115/2007, 51/11, 164/13, 41/14, 33/15, 156/15, 193/15 dhe 53/16), dhe dispozitat e nenit 2 të këtij ligji me të cilin neni 7 paragrafi 3 pika 5) plotësohet me aline të re 6, nuk do të zbatohen nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji deri më 1 shtator 2018.

Neni 4

Drejtori që emërohet në periudhën nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji deri më 1 shtator 2018, obligohet ta përmbushë kushtin për njohjen e gjuhës së huaj më së voni në afat prej një viti nga dita e emërimit të tij.

Drejtorit i cili nuk do ta përmbushë kushtin për njohjen e gjuhës së huaj në afatin e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni i pushon mandati.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".